

URDHËR I PËRBASHKËT

Nr. 234, datë 10.9. 2018

PËR SHKËMBIMIN E INFORMACIONIT MBI PASURITË E PALUAJTSHME TË REGJISTRUARA DHE TJETËRSIMIN E TYRE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 273, datë 16.5.2018, “Për krijimin e regjistrit qendror të bazës së të dhënave për llogaritjen e taksës vendore të pasurisë së paluajtshme “ndërtesë” (kadastra fiskale)”,

URDHËROJMË:

1. Në kuadër të krijimit të regjistrit të bazës së të dhënave për llogaritjen e taksës vendore të pasurisë së paluajtshme “ndërtesë”, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Agjencia e Legalizimit Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale dhe Drejtoria e Përgjithshme të Taksës së Pasurisë, të realizojnë shkëmbimin e informacionit mbi pasuritë e paluajtshme të regjistruara, pasuritë e paluajtshme të legalizuara dhe në proces legalizimi ose jo, si dhe informacionin e plotë mbi tjetërsimin e tyre.

2. Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të vendosë në dispozicion të Drejtorisë së Përgjithshme të Taksës së Pasurisë dhe të mundësojë marrjen e vazhdueshme të tyre brenda çdo tremujori të dhënat identifikuese të pasurisë (zona kadastrale, numri i pasurisë, adresa, volumi, faqja etj.), përshkrimin e pasurisë (sipërfaqja e ndërtuar, lloji i pasurisë etj.), pronësinë (emri/at i/e pronarëve), si dhe në mënyrë specifike vlerën e transaksionit dhe datën e kryerjes së tij në rastin e shitblerjes së pasurisë.

3. Agjencia e Legalizimit Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale të vendosë në dispozicion të Drejtorisë së Përgjithshme të Taksës së Pasurisë të dhënat që disponon mbi pasuritë e paluajtshme “ndërtesë” për qëllim të taksës së pasurisë dhe të mundësojë marrjen e tyre.

4. Informacioni i mësipërm t’i vihet në dispozicion Drejtorisë së Përgjithshme të Taksës së Pasurisë nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Agjencia e Legalizimit Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/ Ndërtimeve Informale në format elektronik kur ai disponohet për një pasuri ose në rrugë shkresore.

5. Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë garanton marrjen e të dhënave dhe përdorimin e tyre vetëm për qëllime të taksës së pasurisë.

6. Ngarkohen Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Agjencia e Legalizimit Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/ Ndërtimeve Informale dhe Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE DHE EKONOMISË

Arben Ahmetaj

MINISTRI I DREJTËSISË

Etilda Gjonaj